

Njëzetë vjet vonesë, përcaktoni datën:

Letra të hapura nga Qendra e Ndhmës së Drejtëdrejtë, thirrje të hapura:

Ne jemi ende këtu!

Të dashur njerëz që keni provuar Qendrën e Ndhmës së Drejtëdrejtë,

Zërat tuaj janë të fuqishëm. Për vite me radhë, njerëzit që jetonin në Qendrën e Ndhmës së Drejtëdrejtë kanë shkruar letra të hapura, kanë ndarë së bashku thirrjet e tyre nëpër rrjetet sociale, kanë protestuar në mbrojtje të të drejtave dhe kërkesave të tyre, si dhe kanë kërkuar t'i japin fund qëndrimit në Qendrën e Ndhmës së Drejtëdrejtë. Ju keni realizuar ndryshime reale dhe keni bërë të mundur që të mbërrinin në këtë moment historik, në të cilin qeveria e re ka premtuar fundin e Qendrës së Ndhmës së Drejtëdrejtë, pas njëzet vitesh me këtë sistem mizor.

Ndërkohë që ky premtim është mirëpritur, ne duhet të vazhdojmë të ushtrojmë presion. Qeveria duhet t'i japi urgjentisht fund Qendrës së Ndhmës së Drejtëdrejtë, si dhe të sigurojë ruajtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Ne të Amnesty International dëshirojmë të sigurojmë që zërat tuaj të vazhdojnë të dëgjohen deri në nivelet më të larta, ndaj po jua dorëzojmë juve platformën tonë, në mënyrë që t'i thoni qeverisë se “ne jemi ende këtu”.

Ne ju ftojmë t'i shkruani një letër të hapur qeverisë.

Tregojini atyre se kush jeni, kujtojini se ju jeni ende këtu dhe tregojini shpresat tuaja për përfundimin e qëndrimit në Qendrën e Ndhmës së Drejtëdrejtë. **Thuajini atyre** se tashmë u bënë njëzetë vjet vonesë dhe se ata duhet të veprojnë tani në përcaktimin e datës. Ne kemi nevojë për një plan implementimi, si dhe për një afat kohor për përiudhën dhe mënyrën e përfundimit të qëndrimit në Qendrën e Ndhmës së Drejtëdrejtë.

Ne do t'i ndajmë letrat tuaja të hapura së bashku me një auditor më të gjerë, duke i publikuar ato online.

Ne do të përzgjedhim disa prej letrave për autorizim të mëtejshëm dhe do t'i kthejmë në video për rrjetet sociale. Nëse e keni më kollaj ju mund të zgjidhni mundësinë për ta lexuar letrën tuaj, ose të vihet një aktor që të lexojë fjalët tuaja.

Secili autor letre të autorizuar do të paguhet.

Ju mund të shkruani në çdo gjuhë.

Ju mund të qëndroni anonim.

Ju mund ta shkruani letrën tuaj personalisht ose në grup.

Dërgoni letrat tuaja tek act@amnesty.ie brenda 15 tetorit.